



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.02.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Seancë dëgjimore me grupet e interesit që merren me importin e makinerive bujqësore lidhur me zbatimin e ndryshimeve të fundit të Ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka, Vullnet Sinaj dhe Edmond Panartiti.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli Lorenc Luka, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Julinda Bare – Specialiste e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural

Nikolin Lera – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuci – Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Thanas Andoni – Drejtor i Tarifës dhe i Origjinës në Drejtorinë e Doganave
Amarildo Dervishi – Specialist pranë Sektorit të Tarifës në Drejtorinë e Doganave
Xhorxh Marku – sipërmarrës , importues i makinerive dhe i mjeteve bujqësore
Fatos Pogani – Përfaqësues i kompanisë “Pogoni” sh.p.k
Bashkim Myrto – Përfaqësues i kompanisë “Albakren” sh.p.k.,Fier
Arshi Myrto – Përfaqësues i kompanisë “Albakren” sh.p.k.,Fier
Tauland Greku - Përfaqësues i kompanisë “Albakren” sh.p.k.,Fier
Tomorr Myrto - Përfaqësues i kompanisë “Albakren” sh.p.k.,Fier
Agim Rrapaj - Kryetar i Këshillit Agrobiznesit Shqiptar dhe Kryetar i Shoqatës
Shqiptare të Mekanikës dhe Mjeteve Bujqësore.
Kujtim Xhudi – Importues i mjeteve bujqësore. Kompania "GERTA" sh.p.k.
Xhavit Sula – Kryetar i Asamblesë së Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB)
“Mekanika Bujqësore Shqiptare”
Dritan Zaimi – Administrator i SHBB-së “Mekanika Bujqësore Shqiptare”
Izet Leshi – Pronar i Kompanisë “Agro Shqip”, importues i makinerive dhe i mjeteve
bujqësore

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Mirë se keni ardhur!

Sot në komision kemi parashikuar një seancë dëgjimore me grupet e interesit, lidhur me importin e makinerive bujqësore dhe problematikat e hasura.

Në paketën fiskale të këtij viti kemi miratuar përjashtimin nga TVSH-ja jo vetëm për importin e makinerive bujqësore drejtpërdrejt nga fermerët, por edhe për importin apo tregtimin e makinerive bujqësore brenda vendit. Ndërkohë, komisionet parlamentare, siç është edhe komisioni ynë, kanë të drejtën dhe detyrën të ndjekin zbatimin e ligjeve.

Në këtë kuadër, duke qenë se ne kemi marrë disa vërejtje apo ankesa nga përfaqësuesit e grupit të interesit të importuesve për problematikat që lidhen me zbatueshmërinë e paketës fiskale në praktikë dhe në të drejtën e komisioneve parlamentare për të analizuar dhe për të ndjekur zbatueshmërinë e ligjeve, po thërrasim këtë seancë dëgjimore.

Në këtë seancë dëgjimore nuk kemi ftuar vetëm përfaqësuesit e grupeve të interesit, të cilëve do t'ju kërkoja që sapo të marrin fjalën, të prezantohen, edhe disa përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Njëri prej tyre është zoti Ilir Halilaj, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Këto janë 3 institucionet, që ne mendojmë se lidhen me zbatueshmërinë e këtij ligji të paketës fiskale. Shpresojmë që në fund të kësaj dëgjese, edhe institucionet të sqarojnë rolin e tyre.

Nga ana tjetër, nëse ka nevojë për një bashkërendim më të shpejtë dhe më efikas, të realizohet brenda një afati që mund të përcaktohet edhe këtu. E kuptojmë ndjeshmërinë e kësaj problematike, e cila lidhet me një aktivitet, që nuk është vetëm tregtar, por është edhe në dobi të një sektori shumë të rëndësishëm, siç është zhvillimi rural. Sa më shpejt të zbatohet në praktikë dhe pa burokraci ligji për këtë përjashtim të TVSH-së, aq më shumë do të energjizohet tregu i mekanikës bujqësore dhe i bujqësisë. Kam parasysh se sapo kanë mbaruar aplikimet për IPARD-in që është programi më i madh historik i mbështetjes së bujqësisë dhe i zhvillimit rural. Kjo e bën edhe më emergjente dhe më të nevojshme këtë dëgjese për të zgjidhur një problematikë që, siç e thashë, lidhet me prodhimin e makinerive bujqësore. Pa humbur kohë,

kalojmë në fjalën e përfaqësuesve të grupit të interesit. Kush do të flasë, të prezantohet paraprakisht!

Më pas do të vijojmë me pyetje dhe me diskutime.

Urdhëroni!

Agim Rrapaj - Unë jam kryetar i Këshillit Agrobiznesit Shqiptar dhe kryetar i Shoqatës Shqiptare të Mekanikës dhe Mjeteve Bujqësore në Shqipëri. Ju falënderoj për këtë dëgjesë, sepse na shërben dhe po bëhet në kohën e duhur!

Ne kemi një shqetësim shumë i madh lidhur me problematikën që kemi hasur në vitin e kaluar dhe në këto ditë për importin e mekanikës dhe mjeteve bujqësore, i cili është i lidhur ngushtë (është si thembra e Akilit), për qendrat që shesin mekanikë dhe mjete bujqësore. Vitin e kaluar këto kanë pasur TVSH, kur fermerët nuk kishin me TVSH. Në të njëjtën kohë vendet e rajonit përreth nesh, nuk kishin TVSH. Këto kompani kanë qenë të pafavorizuara dhe janë në vështirësi të jashtëzakonshme. U hodh hapi i duhur për heqjen e TVSH-së për këto makineri bujqësore, por ka një paqartësi në lidhje me këtë çështje nga tatimet dhe doganat.

Deri më sot kjo lehtësi që është përcaktuar në ligj nuk po zbatohet dhe asnjë importues nuk ka bërë asnjë veprim deri sa të sqarohet ky problem.

Është një shans që komisioni e mori në shqyrtim këtë çështje për ta sqaruar. Unë do të doja që të flisnim edhe më gjerësisht për këtë çështje. Me dy fjalë, në Shqipëri kanë qenë 54 qendra që shisnin mekanikë bujqësore, ndërsa sot janë rreth 4-5 në eficiencë. Pjesa tjetër nuk janë në eficiencë. Pa importuesit e makinerive bujqësore dhe pa shitjen me garanci të mjeteve të reja, ne do të vazhdojmë ta kemi sistemin e mekanikës bujqësore në vend, të shkatërruar. Prandaj, është e domosdoshme që ne të hedhim edhe hapa të tjerë. Meqë sot është e kufizuar vetëm për importin, unë do të përqendrohesha te sqarimi i këtij fenomeni në mënyrë që të fillojë veprimtaria praktike.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Dakord.

Ka tjetër? Urdhëroni!

Fatos Pogoni – Unë jam përfaqësues i kompanisë “Pogoni” sh.p.k., që merret me importin e mekanikës dhe mjeteve bujqësore, të reja dhe të përdorura. Desha të them në lidhje me problemin që tha kryetari i KASH-it pak më parë, se unë kam bërë një import të këtyre

mjeteve dhe nga doganat më është lejuar të importoj pa TVSH vetëm traktorin me kodin MKB. Mjetet e tjera, siç janë frezat apo motokultivatorët, të cilat janë pajisje me motor që ne mund t'i quajmë makina apo diçka tjetër, me kapacitet 10-12-13 kuaj fuqi, i kam zhdoganuar me TVSH. Ky është shqetësimi i parë.

Ndërkohë, unë e kam problem edhe shitjen brenda vendit. Për mua është shumë e rëndësishme sqarimi i kësaj çështjeje. Ne kemi një muaj apo më shumë. Këtu mund të flas edhe për partnerët tanë, sepse ne nuk po i shesim dot. Nga Drejtoria e Tatimeve na thonë: “Nuk dimë se çfarë t’ju themi. Shitini me TVSH”, kurse nga ana tjetër, na thonë: “Shitini pa TVSH”, ose: as me TVSH, as pa TVSH. Ky është një ngërç shumë i madh. Ne i kemi mbajtur të bllokuara shitjet tona dhe nuk e dimë se si do të ecim më tutje.

Faleminderit!

Izet Leshi – Përshëndetje!

Unë jam përfaqësues i kompanisë "Agro Shqip", Lushnjë, importues i makinerive dhe i mjeteve bujqësore. Na është bllokuar puna, sepse kemi 3 muaj që jemi përgatitur për heqjen e TVSH-së. Sezoni po vazhdon dhe ne jemi bllokuar totalisht dhe nuk po dimë se si të ecim.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Më fal, Berti!

Nëse ke diçka për të thënë, fol me mikrofon!

Robert Bitri – Çfarë tematike kemi brenda kësaj problematike? Kemi problemin e TVSH-së, si do të shitet, kush do të jepet me TVSH dhe kush do të jepet pa TVSH. Të flasim brenda kësaj tematike. Nuk ka nevojë të ngrihen tematika të tjera. Sot ne kemi për të sqaruar këtë çështje, prandaj u ngrit problemi në komision, prandaj kryetari organizoi këtë takim për ta sqaruar përfundimisht se kush do të jepet pa TVSH, si do të futen dhe se si do të veprohet në Shqipëri. Këtu kemi edhe drejtorin e Doganave, edhe atë të Tatimeve, edhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, edhe përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ne si komision, pas ankesave që bëtë ju, dolëm në përfundimin se kemi një shqetësim dhe sot ju kemi ftuar t’ju dëgjojmë dhe të sqarojmë përfundimisht se ku e kemi ngritur ne dorën, çfarë kemi miratuar në parlament dhe se çfarë do të zbatohet në terren me njerëzit që kemi atje.

Niko Peleshi – A ka ndonjë nga grupet e interesit, që do ta sqarojë këtë problematikë?
Urdhëroni!

Bashkim Myrto – Unë jam përfaqësues i kompanisë “Albakren” sh.p.k. Fier. Merrem me importimin e makinerive bujqësore që nga viti 1994. Na është dhënë mundësia që me kërkesat që ka pasur tregu shqiptar gjatë gjithë kësaj kohe, të fusim në vend rreth 2000 traktorë kryesisht të përdorur, që ne i kemi nga Japonia. Gjatë gjithë kohës makineria bujqësore ka qenë me TVSH, por nga viti 2014 iu krijua një mundësi fermerëve të importonin nga jashtë makineri bujqësore pa TVSH. Kjo jo vetëm që na krijoi vështirësi në shitje, por, duke iu referuar edhe fjalës që tha zoti Agim, bie edhe numri i bizneseve në këtë fushë.

E dyta, ka edhe një problem, që këtyre bizneseve ose fermerëve, të cilët importojnë direkt makineri bujqësore, nuk u bëhet dot shërbimi, se e merr makinerinë në Itali, në Gjermani ose kudo, por ku do të shërbehet? Shqipëria po kthehet në një varrezë makinash, por edhe traktorësh.

Kjo është shumë e qartë, sepse në vitin 2014, me sa mbaj mend, ka qenë lista e këtyre makinerive bujqësore, të cilat përjashtoheshin nga TVSH-ja për fermerin, bazuar në vendimin nr. 953 të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë, në vitin 2019 vendimi nr. 9 i Këshillit të Ministrave, thotë: “Për të vazhduar vijueshmërinë e këtij biznesi, të përshtaten me aneksin nr. 1 të këtyre makinerive”, i cili është shumë i qartë. Tani ka ngelur dhe ne nuk dimë si të bëjmë, as andej, as këtej. Të importojmë, nuk importojmë; të shesim, nuk shesim. Ca nga largimi i bizneseve, ca edhe nga largimi i njerëzve, ky biznes po shuhet. Por ç’është më e keqja, është se kështu shuhet edhe vetë bujqësia. Sepse si do të shërbehet pa mekanik? Pra, duam ta sqarojmë.

Niko Peleshi – Pikërisht do ta sqarojmë, se prandaj jemi këtu.

Domethënë, paketa fiskale e këtij viti e kishte këtë normalisht si qëllim që të rregullonim, le ta quajmë, një handicap të së kaluarës, ku përjashtimi nga TVSH-ja për importet e makinerive bujqësore ishte bërë vetëm për importet e drejtpërdrejta nga fermerët, gjë që kishte filluar të zhvendoste, si me thënë, edhe përfaqësuesit e kompanive serioze këtu, sepse, në qoftë se e importoje për qëllim rishitjeje mekanikën bujqësore, duhet të paguajë TVSH-në, ndërkohë që në qoftë se importoje si fermer, nuk e paguajë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, Niko, sa ta mbaroj! Më korrigjoni nëse e kam gabim.

Për ta rregulluar këtë handicap, në paketën fiskale të këtij viti ne përfshimë edhe importet me qëllim rishitjeje, ku përfitojnë edhe kompanitë, të paktën sipas qëllimit të paketës fiskale. Në qoftë se ka ndonjë ngërç apo nevojë për ndonjë akt nënligjor, apo rifreskim liste e të tjera, do t'i sqarojmë këtu, madje për këtë arsye kemi ftuar në komision edhe Ministrinë e Financave, edhe Ministrinë e Bujqësisë.

Kështu që, pasi besoj se e kemi kuptuar problematikën, ia jap fjalën zotit Lera nga Ministria e Financave për të bërë sqarimin e tij.

Nikolin Lera – Faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu sikurse edhe ju e përmendët, në vitin 2018, por edhe më parë, ne kemi ndërmarrë ose kemi prezantuar, si Ministri e Financave, një sërë masash, të cilat kanë synuar reduktimin e kostove të prodhimit në bujqësi, stimulimin e bujqësisë, të eksportit dhe të produkteve bujqësore.

Unë po përmend disa nga masat që janë marrë, në kuptim të uljes së tarifave dhe përjashtimit nga tatimet lidhur me sektorin e bujqësisë.

Përjashtuam nga TVSH-ja shërbimin veterinar, të kërkuar nga vetë përfaqësuesit e biznesit; përjashtuam nga TVSH-ja importin e inputeve bujqësore, ku efekti negativ në buxhetin e shtetit është 1,8 miliardë, por që është efekt pozitiv në reduktimin e kostove të prodhimit nga fermerët shqiptarë; ruajtëm skemën e autofaturimit, megjithëse të reduktuar. Ndoshta jemi vendi i vetëm në rajon që i kemi këto dy mekanizma, pra edhe përjashtimin totalisht nga TVSH-ja e inputeve, por edhe një rimbursim ose kompensim të TVSH-së së atyre pak inputeve, që mund të mos jenë përjashtuar, në nivelin 6%. Asnjë vend i rajonit nuk i ka të kombinuara në këtë masë këto dy elemente, të cilat mbështesin bujqësinë.

Së treti, kishim të përjashtuar importin e makinerive bujqësore që bëhej nga vetë fermeri. Ligji që ndryshoi thoshte: “Importi i makinave bujqësore, lista e makinave bujqësore, procedura e përjashtimeve dhe kriteret përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Ne nuk kemi bërë gjë tjetër, veçse nenin që ka qenë vetëm për fermerët në importin e makinerive, e kemi marrë *copy-paste* dhe e kemi vendosur në furnizimet e brendshme, sepse nëse është në nenin e furnizimeve të brendshme makina e përjashtuar, automatikisht është edhe në import, pasi kjo u kërkuar.

Tjetër çështje, ligji ka të parashikuar importin e kafshëve të gjalla. Po kështu...

Niko Peleshi – Më fal, Niko, që të mos zgjerohemi...!

Nikolin Lera – ...importi, edhe në qoftë se është e rëndësishme...

Niko Peleshi – Niko, të lutem, dëgjesa është vetëm...!

(Diskutime në sallë)

Më takonte mua para jush për të bërë edhe prezantimin.

Nikolin Lera – Lidhur me makineritë, element tjetër...

Niko Peleshi – Niko, të lutem!

A ka mundësi pak qetësi në sallë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, një sekondë, sa të mbarojë zotëria!

Të gjitha ato sa që thatë ju qëndrojnë, janë të vërteta, por, ju lutem, të përqendrohemi vetëm te çështja e TVSH-së. Pra, me sa po sqaronit ju, ndryshimi që është bërë në paketën fiskale nuk ka të bëjë as me reduktimin e ndonjë liste, as me gamën e importit, por vetëm me zgjerimin e kategorisë që përfiton: jo vetëm fermerët që importojnë drejtpërsëdrejti, por edhe kompanitë që importojnë për qëllim rishitjeje.

Nikolin Lera – Ato që përfitojnë fermerët, i përfitojnë edhe importuesit.

Niko Peleshi – Dakord.

Nikolin Lera – Ky është ndryshimi që u bë.

Niko Peleshi – Ku kemi ngecur tani, se këtë duam të kuptojmë?

Nikolin Lera – Ndërkohë, elementi i fundit, zoti kryetar, është se importi i makinerive dhe i pajisjeve që bëhen në funksion të agrobiznesit, pra nga vetë subjektet që janë në fushën e agrobiznesit, është tërësisht i përjashtuar nga TVSH-ja.

Niko Peleshi – Dakord. Tani ku kemi ngecur? Pse ka probleme me zbatimin në praktikë?

Nikolin Lera – Nuk e di se çfarë problemesh hasin, por këto mund të na i sqarojë përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave që administron importet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Më falni!

Me radhë, ju lutem, se kjo mbledhje është e hapur, kemi ftuar dhe kanë hyrë të gjithë që kanë dashur të jenë pjesë, por të paktën të respektojmë etikën e zhvillimit të mbledhjes!

Fjalën e ka zoti Panariti për një sqarim, pastaj do t'ia jap fjalën përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Edmond Panariti – Faleminderit, zoti kryetar!

Në qoftë se do ta përshkruaja me një fjalë çështjen e lehtësive fiskale të bujqësisë, do ta filloja kështu: “Çfarë dëgjoj i lumi unë, çfarë shikoj i mjeri unë”. Domethënë, praktikisht në letër vendimmarrja është e qartë, ndërkohë që kur vjen puna për ta zbatuar, nuk kemi zbatim. Madje u tha fare qartë këtu, se kur bëhet fjalë për privim nga TVSH-ja të importeve të makinerive bujqësore, bëhet fjalë për një grup në total të makinerive bujqësore, pra jo vetëm për traktorët, përjashtoj zëtorët, hiq agregatet, hiq plugjet, frezat e të tjerë.

Prandaj këtu, një njëfarë mënyre, duhet parë, sepse ka abuzivizëm, por këtu duhet parë edhe përgjegjësia përse kjo masë nuk zbatohet në tërësi për mekanikën bujqësore ashtu siç është parashikuar edhe në vendimmarrje, në ligj, i cili specifikon se mekanika bujqësore përjashtohet nga TVSH-ja në totalin e saj.

Zotëria e tha shumë qartë: për traktorin ke të drejtë ta heqësh, për frezën, ndërsa për plugun, për motokultivatorin jo. Kjo është tallje dhe në këtë mes ka edhe një fyerje të atij akti normativ, i cili në total përfshin mekanikën bujqësore.

Po të kemi parasysh që mekanika bujqësore në Shqipëri është e detyruar të punojë edhe me naftën më të shtrenjtë, jo në rajon, por po them në Europë, mendoni pastaj sa është kostoja fundore e plugimit, e frezimit, e lërimin të një hektari apo të një dynymi të sipërfaqes së tokës. Prandaj të jemi konkretë dhe të qartë, zotërinj. Nëse kemi vendosur t’ia heqim këtë barrë fiskale bujqësisë, sepse është e vetmja gjë që mund të bëjmë, pasi i japim shumë pak para, në total, si subvencione, si mbështetje e të tjerë, mos e llogarisni IPARD-in, sepse IPARD-i nuk është ndonjë meritë e madhe e qeverisë shqiptare, por janë para që i jep Bashkimi European dhe që patëm rastin ta firmosnim qëkur unë isha ministër, por që tashmë sfida e madhe është disbursimi i atyre parave. Ajo që duhet të bëjë shteti shqiptar është rritja e mbështetjes dhe heqja e barrës së papërbalueshme fiskale.

Aty ku marrim një vendim dhe që e votojmë të gjithë, shikojmë që nuk zbatohet. Tani favorizohen..., se këtu duhet parë edhe ajo, se ndoshta ka diçka në këtë mes, ndoshta favorizon firmat “nënë” atje për të importuar direkt dhe për të dalë jashtë loje i gjithë biznesi, i cili, në njëfarë mënyre, siç u përmend këtu pak më parë, me të drejtë, siguron edhe servisin, edhe mirëmbajtjen e makinerive bujqësore, gjë që nuk ia garanton firma “nënë”, e cila ta shet dhe nuk do t’ia dijë.

Prandaj këtu, se edhe shpjegimi ishte pak a shumë evaziv, nuk arrita ta kuptoj pse nuk zbatohet ky akt, i cili tashmë ka kaluar në trajtën e një ligji, për privimin nga TVSH-ja të makinerisë bujqësore të importuar nga të tretë, që operojnë në këtë fushë, dhe pse kjo fragmentohet ose segmentohet në disa pajisje, ndërsa pjesa tjetër, që për mua është edhe më e rëndësishme (që janë agregatet, motokultivatorët, frezat e të tjerë), ngarkohen me këtë masë TVSH-je.

Kjo është një pyetje, në radhë të parë, për drejtorin e Doganave, por sigurisht kërkoj një sqarim ose komentin e vetë shoqatave...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Pak qetësi, ju lutem!

Edmond Panariti – ...pse e shikojnë veten të diskriminuar në këtë mes, kur praktikisht ne kemi marrë një vendim, që mekanika bujqësore në totalin e saj duhet të privohet nga TVSH-ja në importet e aggregateve, të traktorëve, të frezave, të motokultivatorëve në tërësi?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Dakord.

Tani, për t'i shërbyer çështjes, është mirë të mos e ngarkojmë politikisht, sepse...

Edmond Panariti – Nuk është politike kjo.

Niko Peleshi – Më falni, ta mbaroj!

Edmond Panariti – Kjo është vendimmarrje, që e kemi marrë ne, nuk është politike!

Niko Peleshi – Nuk ju ndërpreva kur folët.

Edmond Panariti – Zbatoni atë që është vendosur.

Niko Peleshi – Dakord.

E para, kjo lehtësi fiskale nuk ka rënë nga qielli, por ka ardhur si propozim i qeverisë shqiptare dhe i vullnetit të maxhorancës që e ka votuar. Pra, nuk bëhet fjalë për vullnet apo mungesë vullneti për ta mbështetur ose jo sektorin. Nuk diskutohet që është vullneti politik që e solli këtë paketë fiskale, që u votua me votat e maxhorancës në parlament dhe sot e kemi në fuqi.

Natyrisht, ka një problematikë, që na ka mbledhur këtu, por edhe fakti se para pak ditësh përfaqësues të grupit të interesit kanë folur me zotin Bitri, më kanë kontaktuar edhe mua drejtpërsëdrejti, pra kaluan vetëm pak ditë dhe ne organizuam këtë dëgjese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, ky takim, kjo dëgjese është dëshmi e seriozitetit dhe e vullnetit politik për ta zgjidhur, jo për të përfituar ne ndonjë kredo politike dhe elektorale, sepse nuk do të ishte shumë e drejtë. Këtu jemi për të zgjidhur problemin. Unë mund të flas për paketën fiskale në përgjithësi, por nuk dua të bëj të njëjtin gabim. Ne nuk jemi vendi me ngarkesën më të madhe fiskale, por pas kësaj pakete fiskale jemi vendi me ngarkesën më të ulët fiskale për bujqësinë në të gjithë rajonin. Asnjë vend tjetër nuk e ka zero TVSH-në e inputeve bujqësore, siç ne e bëmë këtë vit.

Padyshim që IPARD-i është edhe meritë e qeverisë shqiptare. Ju, zoti Panariti, e dini mirë që duhet të kalosh disa provime derisa të marrësh të drejtën e menaxhimit në mënyrë të decentralizuar të IPARD-it. Pra, janë para europiane që i janë besuar qeverisë shqiptare pasi ka kaluar disa provime dhe është akredituar për të qenë e tillë. Por ta mbajmë larg këtyre diskutimeve politike dhe të përqendrohemi te çështja teknike.

Pra, duket sikur ka një ngërç, që mund të jetë burokratik, por besoj se sqarimi i drejtorit të doganave do të na e bëjë pak më të lehtë për ta zgjidhur këtë ngërç.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, ta dëgjojmë pak, sepse mbase sqarohemi. Më pas e ka fjalën zoti Suli.

Thanas Andoni - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë quhem Thanas Andoni dhe jam drejtor i Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Nga ana e zbatimit teknik më lejoni t’ju sqaroj që dogana nuk ka ndryshuar zbatimin teknik të këtij kuadri ligjor, por për makinat bujqësore, siç e tha edhe zoti Lera, është liberalizuar më shumë. Nëse më parë importohesh vetëm nga fermerët, tani importohet nga çdo importues. Për makineritë vazhdojnë kriteret që janë të parashikuara te VKM-ja nr. 953, sipas listës të caktuar në aneksin e kësaj VKM-je. Për mendimin tim duhet të dallojmë diferencën midis makinerive dhe makinave. Në paketën fiskale ka një ndryshim për makinat bujqësore, të cilat tashmë mund të importohen nga çdo tregtar, kurse makineritë bujqësore rregullohen me VKM-në nr. 953 dhe duhet të importohen nga fermerë ose agrobiznes me aplikim që dorëzohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas kriterëve që ka kjo VKM.

Faleminderit!

Edmond Panariti – Pse kjo nuk grupohet në termin “mekanikë bujqësore”, sepse po luani me termat “makinë” dhe “makineri”? Është mekanikë bujqësore që privohet nga ngarkesa

me TVSH? Mos e fusni në kanale që sektori nuk e meriton të futet, sepse bëhet fjalë për mekanikë bujqësore, agregate në tërësinë e tyre. I lini këto lojëra, sepse nuk i bëjnë nder askujt. Ne kemi marrë një vendim në tërësi që ta privojmë sektorin nga TVSH-ja.

Niko Peleshi – Zoti Panariti, e ka kërkuar fjalën zoti Suli.

Rakip Suli – Faleminderit, zoti kryetar!

Serioziteti i këtij komisioni duket në takimin që ju është mundësuar grupeve të interesit. Përgjigjja e Drejtorisë së Doganave nuk ishte aspak e qartë dhe unë nuk u qartësova. Kam një pyetje të drejtpërdrejtë për Ministrinë e Financave. Nëse implementimi i heqjes së TVSH-së për makineritë nuk është zbatuar për muajin janar, kush do të mbajë përgjegjësi? Ne si komision duhet të kemi njoftim për masat që janë marrë nga kjo ministri. Nëse nuk është implementuar zbatimi i ligjit për heqjen e TVSH-së për makineritë, duam informacion me shkrim çfarë masash janë marrë.

Së dyti, të mos i bëjmë gjërat politikisht, sepse nisma e fundit e qeverisë ka qenë shumë e rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taksa për inputet bujqësore u bë zero.

Edmond Panariti - Nuk po atakoj vendimin, sepse ai është i qartë, por pse nuk zbatohet? Unë thashë: “Për atë që dëgjoj, i lumi unë, për atë që shikoj, mjeri unë”.

Niko Peleshi - Duhet një sqarim nga zoti Lera, sepse më duket sikur thatë dy gjëra të ndryshme. Edhe ju si drejtori i doganave mendoni?

Ju thatë që të gjitha përjashtimet që i përfitonin fermerët, mbas kësaj pakete fiskale i përfitojnë edhe kompanitë. Fermerët përfitonin makina dhe makineri, pra, të gjithë mekanikën bujqësore, dhe, sipas fjalës suaj, duhet që po këto përjashtime t’i përfitojnë edhe kompanitë sot. Pra, edhe makina edhe makineri. Drejtori i doganave bëri një ndarje që unë nuk e kuptova mirë.

Nikelin Lera – Unë nuk jam njohës shumë i mirë i kodeve doganore dhe alookimeve në kode, por sqaroj se ne bëmë *copy paste* nenin që përjashtonte fermerin dhe e implementuam edhe për tregtarët.

Niko Peleshi – U sqarove zoti drejtor i doganave?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rakip Suli – Së pari, unë kërkoj nga Ministria e Financave informacion me shkrim për zbatimin e ligjit, sepse dikush ka përgjegjësi.

Së dyti, a është qartësuar, sepse zotërinjtë ngritën tri problematika.

Ishte e pamundur shitja brenda vendit. Nëse e blen një traktor, nuk është e thënë që ai do të vdesë bashkë me traktorin, sepse nesër mund ta shesë te dikush tjetër. A kanë informacion tatimet që kur personi e shet traktorin të mos taksohet me TVSH?

E fundit, a është përcaktuar lista e saktë për të gjitha makineritë që i përkasin bujqësisë që të jetë te lista e doganave? Nëse ne vazhdojmë të lëmë hapësira te doganat, fillojnë abuzimet nga vetë punonjësit e doganave. Kjo është përgjegjësia e Ministrisë së Financave. Nëse qeveria shqiptare ka pasur përkushtimin e jashtëzakonshëm në mbështetje të fermerëve, mendoj që kjo ka ngelur te Drejtoria e Doganave, e cila duhet të jetë më e përgjegjshme për zbatim e kësaj. Për këtë kërkojmë informacion me shkrim.

Faleminderit!

Robert Bitri – Ka një fjalë shqip: “I zoti e shet, tellalli s’e jep”. Qeveria dhe parlamenti e miratojnë, ju nuk e zbatoni ashtu siç duhet. Tani na e sqaroni mirë, se ne kemi ngritur duart për të dyja.

Ju thatë: “*Copy paste*”. *Copy paste* do të thotë që, siç ishte për këta, të kalojë direkt për firmat. Ku është zbatimi këtu, se nuk po e marrim vesh?! Prandaj është bërë edhe takimi. Prandaj edhe kryetari e kërkoi. Qeveria, parlamenti dhe shumica parlamentare është dakord dhe ju vini në diskutim... Kemi thënë se do të bëhet kjo, kjo, kjo... E miratuam, ngritëm duart... Sqarojeni këtë!

Niko Peleshi – Ta dëgjojmë pak edhe përfaqësuesin?

Fatos Pogoni – Dëgjova që u tha se ajo që ka qenë për fermerët do të aplikohet edhe për ne. Pyetja ime është: a mund të importojnë fermerët edhe sot me të njëjtat kritere që kanë importuar deri dje, pra me një nipt fermeri, me një dokumentacion mbështetës...?

Te vendimi nr. 953, neni 8, që rregullonte dhe përcaktonte kriteret, pika 4/5 është shfuqizuar me VKM-në e re nr.12, datë 9 janar. Si ka mundësi që fermerët sot do ta fusin, kur kjo pikë është e shfuqizuar?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, edhe fermerët nuk mund ta fusin, me sa di unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Kam një pyetje: listën e mekanikës bujqësore (sepse listën nuk e ka ligji) cili e ka?

Thanas Andoni – VKM-ja nr. 953 viti 2014.

Niko Peleshi - Ka ndryshuar kjo VKM?

Thanas Andoni – Aneksi nuk është shfuqizuar.

Niko Peleshi – Kush e bën diferencimin mekanik, makineri dhe makina, përderisa lista, së cilës i referohet ligji, është e pandryshuar?

Zoti drejtor i doganave, dëgjoje pak pyetjen time!

Nëse kemi të njëjtën listë, e cila dje përjashtohet për fermerët dhe sot përjashtohet edhe për blerjet për qëllim rishitjeje, pra edhe për kompanitë, atëherë, përse bëni diferencim brenda kësaj liste? Është e njëjta listë. Nuk ka ndryshuar lista.

Thanas Andoni - Faleminderit, zoti kryetar!

E kuptova mirë pyetjen.

Kodifikimi, klasifikimi tarifar në doganë, bazohet në nomenklaturën e kombinuar të mallrave. Për pjesën e makinerive, siç u diskutua edhe këtu, do të ishte e nevojshme që bashkë me Ministrinë e Bujqësisë të ndanim se cilat janë makinat bujqësore që përdoren, që ne të bëjmë kodifikimin me kodin tarifar të doganës.

Po të marrim si shembull traktorin ose autokombajnën, këto janë makina bujqësore. Pjesa tjetër e makinerive, që janë tek aneksi 1 i VKM-së nr.953, janë bujqësore. Mund të marr si shembull, nëse më lejoni, makinat për përpunimin e qumështit. Ai që i sjell duhet të ketë aktivitet agrobiznesi dhe të aplikojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe në qoftë se kodi parashikohet te kjo listë, ato përjashtohen nga tatimi.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Mos hyni në këtë diskutim!

(Diskutime pa mikrofon)

Këto që thanë zoti Beqaj dhe zoti Bitri qëndrojnë.

Ju lutem, nëse keni ndër mend të flisni nga vendi dhe pa radhë...!

Nëse dikush nuk rri dot pa folur, mund të na presë jashtë sa të mbarojë takimi. Është e pamundur të zhvillohet mbledhja kur të gjithë flasin nga vendi. Kështu bëhet kakofoni. Kush nuk duron dot, nuk është i detyruar të rrijë!

Mos na fusni në kode, se ne nuk jemi ministria, as dogana, as qeveria.

Të gjitha diskutimet shterohen në momentin kur përgatitet një VKM, një listë. Miratohet lista në Këshillin e Ministrave dhe gjatë këtij procesi diskutohet kodi, se cila quhet makinë, cila quhet makineri dhe se cila nuk quhet makineri apo mekanik bujqësor dhe nuk futet në atë listë.

Ne nuk mund të bëjmë diskutime në themel, ne nuk jemi qeveria. Ne jemi thjesht për të kontrolluar zbatueshmërinë e një ligji të miratuar nga parlamenti. Ligji thotë: “Përfshihen ato makineri apo ato makina që janë pjesë e listës së miratuar me VKM”.

Te lista e miratuar me VKM, ju, zotëri, i jepni të drejtë vetes të bëni diferencime, pra disa t’i quani dhe disa të mos i quani? Apo e merrni listën siç është dhe e aplikoni integrale në doganë? Kjo është pyetja.

Në qoftë se ju i jepni të drejtë vetes të bëni diferencime në listë, mbase keni ndonjë hapësirë dhe ndonjë mbështetje ligjore. Na e sqaroni!

Thanas Andoni – Faleminderit, zoti kryetar!

Dogana është autoritet zbatues, jo vendimmarrës i kuadrit ligjor. Në rastin konkret vepron si agjent i mbledhjes së TVSH-së për tatimet. Në momentin kur kuadri ligjor që vjen është i plotë dhe i sqaruar, ne nuk kemi nevojë për interpretime. Ndoshta do të lindte nevoja që në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të detajohej më konkretisht lista e makinave dhe e makinerive. Megjithatë, në diskutimet që u bënë...

Niko Peleshi - Kjo mund të jetë e vërtetë, por listën që keni sot në fuqi, ju e zbatoni të gjithën?

Thanas Andoni - Patjetër që zbatohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi - Atëherë, pyetja është për ju: a zbatohet lista? Se ky është shqetësimi që na ka mbledhur këtu, që nuk zbatohet lista.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse e kemi kuptuar siç duhet, shqetësimi është që nuk zbatohet lista, apo jo? Këtë po thonë përfaqësuesit e grupit të interesit: “Nuk zbatohet e gjithë lista. Shkojmë në doganë dhe na thonë: “Traktorin po, por këto të tjerat nuk i quajmë””, ndonëse janë pjesë e listës së VKM-së.

Thanas Andoni - Zoti kryetar, në gjykimin tim, nuk mund të ndodhë që dogana të thotë “jo”. Thjesht ka një procedurë tjetër për t’u përjashtuar. Në qoftë se për traktorin, për çdo

importues, është lënë e lirë, regjistrohet traktori dhe nuk ka nevojë për aplikim, për makineritë duhet të sjellë një sërë dokumentacionesh, që i parashikon VKM-ja, por kjo nuk do të thotë se nuk përjashtohet. Aplikon dhe përjashtohet.

Niko Peleshi – Kështu është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush do të falsë në emër të përfaqësuesve të grupit të interesit?

Xhorxhi Marku – Jam Xhorxhi Marku, importues i...

Niko Peleshi – Më fal, një minutë! Para se të flisni, do të prezantoheni, por para se të prezantoheni, do të flasë zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Më konkretisht, nëse është e mundur. Ju që thoni nuk zbatohet. Mund të jetë rasti që një subjekt me NIPT, në një datë, për zërin e kodit, ka paguar taksën dhe nuk është përjashtuar. Kështu bëhet më konkrete, sepse ka dy probleme.

E para, ka zëra që nuk zbatohet në mënyrë uniforme sipas llojit të subjektit. Nëse e ka VKM-ja, ata nuk mund të thonë se kjo nuk përjashtohet. Ndoshta një është për fermerin, një është për tregtarin, një është për agrobiznesin, por ta gjejmë ku është defekti. Na e ilustroni me një shembull konkret. Nëse NIPT-i është sekret tregtar, mos na thoni NIPT-in, por na thoni një subjekt që merret me këtë gjë. Nuk keni pse të na tregoni NIPT-in, sepse nuk ka rëndësi, nuk është aty problemi.

Niko Peleshi – Prezantohuni, ju lutem!

Fatos Pogani – Jam Fatos Pogani.

Nëse është zhdoganuar apo jo, e thashë pak më parë, unë kam zhdoganuar dhe traktori merrte kodin “mkb”, ndërsa të gjitha makineritë e tjera kalonin me TVSH. Ky kod nuk i pranon, nuk i njeh të gjitha agregatet.

Niko Peleshi – Megjithëse janë pjesë e listës, apo jo?

Fatos Pogani – Të gjitha janë pjesë e listës, por nuk i pranon.

Thanas Andoni – Kanë aplikuar për pjesën tjetër që nuk përjashtohet? Domethënë, nëse për traktorin nuk ka nevojë për aplikim, për pjesën tjetër të materialeve, aplikuat në doganë?

Fatos Pogani – Për çfarë të aplikojmë?

Thanas Andoni – Për përjashtim.

Fatos Pogani – Ta kërkojmë nga dogana, të çojmë dokumentacion?

Thanas Andoni – Patjetër.

Fatos Pogani – Ligji është vendosur i tillë, që ne si kompani importuese të plotësojmë një listë dokumentacioni. Ku është e shkruar kjo listë për mua si importues? Jo agrobiznes që kërkojmë makineri dhe pajisje përpunimi, por ...Jam përfaqësues i një kompanie që shet traktorë.

Thanas Andoni – Me sa po kuptoj, zotëri, ju jeni tregtar.

Fatos Pogani – Po.

Thanas Andoni – Parashikohet përjashtim për fermerët e agrobiznesit.

Fatos Pogani – Jo për ne si tregtarë? Tani jemi të qartë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Ndryshimi që ndodhi ishte që makinat bujqësore, ku futet edhe traktori, mund të importohen nga çdokush, jo vetëm nga fermeri dhe agrobiznesi, por nga çdo tregtar, prandaj është lënë i lirë importi. Për sa i përket pjesës tjetër të pajisjeve, agregateve, rregullohen me VKM-në nr. 153.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatos Pogani – Mund të vëmë më pas edhe frezin, edhe për plugun, dhe biskun, edhe makinerinë. Ai nuk do ta marrë traktorin të dalë shëtitje, por do të punojë.

Xhorxh Marku – Jam Xhorxh Marku, importues i mjeteve bujqësore, me një përvojë 40-vjeçare si inxhinier.

Unë dua ta shtroj problemin më gjerë se një akt teknik, që mund të jetë një lapsus apo një handicap ligjor apo një moskompetencë interpretimi në ligj. Kemi 8 vjet që kemi filluar me projektet e Komitetit European, me IPARD-in, me SARED-in dhe sërish tani me IPARD-in e vërtetë. Për 7 vjet, për pasojë të këtij ligji, Shqipëria ka thithur 11 milionë euro, 1 milionë e gjysmë euro në vit, sepse nuk mundet që fermeri shqiptar, që nuk gjen dot Ministrinë e Bujqësisë, të shkojë në Gjermani, në Francë apo në Itali. Këto më duken si ide që nuk funksionojnë. Nuk ka asnjë vend në botë me këtë praktikë. Për të kompletuar përgjegjësinë që ka kjo, mirë që nuk kemi vetë lekë, por pse nuk i marrim ato që jep Europa? Janë 1 milionë e gjysmë euro në vit, kur Maqedonia merr 100-150 milionë në vit.

Niko Peleshi – Mos bëj diskutim politik, ju lutem!

Këto që po thua janë të pasakta. Ju lutem, na sqaroni problemin!

Xhorxh Marku – Problemi është i tillë. Nëse ka ndonjë model të tillë në Europë, në Afrikë, në Azi, ne jemi të gatshëm. Konkretisht, makineritë kanë një term, “makineri bujqësore”. Unë jam inxhinier dhe nuk di të kenë ndryshime teknike në fjalorin shqiptar termat “makinë” apo “makineri”. Janë makineri bujqësore dhe fillojnë nga traktori deri te mekanizmi më i thjeshtë. Se ku qëndron interpretimi dhe leverdia, ne nuk jemi për të përfituar atë që nuk na takon. Flasin për fermerin, jo ne. Më kupton?

Dua të them edhe një detaj tjetër.

Ju, zoti Niko e thatë. Edhe me zotin Edmond, kur ka qenë ministër, unë kam bërë shumë debate. Domethënë, kemi bërë propozime, jo debate, sepse kemi qenë në një linjë. Edhe me ju po ashtu. Në situatën që jemi, që kemi këtë fond përballë, e dëgjova përmbledhjen e TVSH-së dhe unë e ndjej, jam qytetar shqiptar dhe e di që TVSH-ja duhet paguar aty ku duhet, por këtu qeveria ka sektorë prioritarë, e heq nga kjo. Atëherë, ne do të vazhdojmë sërish?

E fundit, nuk ka marrë TVSH qeveria shqiptare nga makineritë bujqësore. Pjesa më e madhe e importuesve kanë ikur nga Shqipëria.

Niko Peleshi – Xhorxhi, faleminderit!

Ky diskutim është shumë i mirë, por do të vlente para paketës fiskale, sepse tani është miratuar. Ne e kemi marrë në konsideratë këtë pretendim. Siç e tha edhe zoti Lera, është bërë *copy-paste* dhe këtë duhet të sqarojmë tani. Kjo do të thotë se lista, nga e cila përjashtoheshin importet e fermerëve në mënyrë të drejtpërdrejtë, është e njëjta. Nga kjo listë përjashtohen edhe importet e kompanive. Këtë dimë ne, që kemi miratuar, këtë dini ju, këtë tha edhe zoti Lera.

Zoti drejtor nga Drejtoria e Doganave tha diçka tjetër, që nga lista e miratuar me VKM, ne si Drejtori e Doganave, bëjmë diferencime. Pra, disa zëra të listës i përjashtojmë nga TVSH-ja për të gjithë, disa të tjera i përjashtojmë vetëm për fermerët, por jo për kompanitë apo agrobiznesit. Unë nuk e di nga ku buron ky diferencim, mbase ju e dini, por, ju lutem, zoti Lera, të na e sqaroni, sepse jeni në dy mendime të ndryshme me drejtorin e Doganave.

Është e vërtetë që ka diferencime në listë apo nga lista që përfitonin fermerët, sot përfitojnë edhe kompanitë rishitëse?

Nikolin Lera – Jo.

Për sa i përket mekanikës bujqësore është vetëm një listë, e cila ka qenë që nga viti 2014, por ndryshimi është se nëse për fermer importonte traktor, siç i kategorizon dogana, me

fuqi motorike, përdorej neni i përjashtimeve që ne kishim te ligji i TVSH-së dhe përjashtojë me atë nen, ndërsa nëse importonte makineri, teknikë tjetër, freza apo të tjera, aplikojë një pikë tjetër e ligjit, aplikojë neni 56, pika 38, që thotë: “Importi i makinerive dhe pajisjeve në funksion të agrobiznesit”.

Sikurse e thamë, e shtrimë përjashtimin e makinave jo vetëm për fermerët, por edhe për tregtarët. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave natyrisht që ka procedurat e saj, që ne do t'i rishikojmë edhe një herë se çfarë problemi kemi dhe, njëkohësisht, nëse është domosdoshmëri. Nëse është e domosdoshme të bëjmë ndonjë rregullim në vendimin e qeverisë që ai të zbatohet në mënyrë të njëjtë për importet jo vetëm për traktorët e zëtorët e tregtarëve, por edhe për agregatet që janë pjesë e tyre, të bëjmë përcaktimet përkatëse, por duke pasur gjithmonë parasysh që të kemi kujdes të mos përfshihen edhe pajisje, të cilat nuk përdoren vetëm në punët e bujqësisë, sepse termi “pajisje bujqësore” është shumë i gjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, një makineri bujqësore e marr edhe unë për kopshtin tim privat. Ne duhet të jemi të kujdesshëm për këtë punë.

Niko Peleshi - A janë të përcaktuara këto mjete në listë?

Nikolin Lera- Lista është në fuqi me VKM-në nr. 953.

Niko Peleshi – Unë po kërkoj zbatimin e kësaj liste.

Nikolin Lera - Mënyra e zbatimit të listës është e ndryshme. Pra, kur një fermer importon traktorin, zbatohet një procedurë e caktuar, ndërsa kur një fermer importon një agregat, zbatohet një procedurë tjetër e caktuar. Këtë do të përpiqemi ta unifikojmë edhe për importet nga tregtarët.

Fatos Pogoni - Kam një pyetje për përfaqësuesit e Drejtorisë së Doganave: deri në 31 dhjetor fermerët importonin traktorët dhe makineritë bujqësore me kodin IO0, i cili nuk ka përjashtime për makinat bujqësore, traktor ose kombajnë dhe për agregatet bujqësore, pra kanë qenë të gjitha në një kod dhe në një procedurë. Fermeri nuk mund ta fuste pa kodin IO0, madje traktori është pjesë e aneksit. Kodet doganore janë të gjitha të përcaktuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka problem për ne, problemin po e shkaktoni ju.

Ilir Beqaj – Nuk pajtohem me atë që thoni ju se Drejtoria e Doganave ka procedurën e saj. Jo, udhëzimet i nxirrni ju si ministri. Po ia lamë çdo lloj nëpunësi nxjerrjen e procedurës, nuk ia gjen dot fillin. Unë kam punuar 35 vjet edhe specialist, edhe drejtor, por po ia dhe specialistit ta bëjë listën, ai e bën siç e ka më mirë për punën vet.

Nikolin Lera - Unë flas për interpretimin e Kodit Doganor.

Ilir Beqaj – Më falni, edhe Kodin nuk e interpreton drejtoria. Kodin e interpreton ai që e ka miratuar, pra ka një parim të përgjithshëm juridik ose shkohet në gjykatë. Unë kam përshtypjen se keni frikë se po bleva unë një korrëse bari për vilën time në plazh, keni hallin e TVSH-së. Pra, ju keni hallin e korrësës së barit të vilës sime? Meqë e përmenda, po ju them se nuk kam vilë. Këtu ka mbetur buxheti i shtetit të TVSH-ja e korrësës së barit të bahçes? Ne e kemi bërë për t'u zhvilluar bujqësia këtë përjashtim TVSH-je. Mund të thotë dikush që edhe prodhimin e transporton me kamion, përjashtoj kamionin. Jo, do të përjashtohet ajo që është direkt në funksion të bujqësisë. Ti shqetësohesh se, po e bleu tregtari, mund t'ia shesë edhe një qytetari që e ka për qejf. Këtu ka mbetur puna? Përveç korrësës së barit apo të ndonjë gërhëre, qytetarët nuk kanë se çfarë të blejnë tjetër. Këtu më duket se qenka e gjithë kontradikta. Gjeni sa korrëse bari janë importuar 5 vjetët e fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por te ajo lista mund të jetë edhe ndonjë gjë që korr.

Niko Peleshi – Zoti Sinaj, keni fjalën.

Vullnet Sinaj – Dëgjova përfaqësuesin e doganës që tha se përjashtohen nga TVSH-ja vetëm fermerët dhe jo tregtarët. Unë do t'ju thosha që çlirojnë edhe tregtarët.

Së dyti, në rast se do të shkojë një fermer të blejë një makinë bujqësore të një tregtar, i cili e ka blerë me TVSH atë makinë bujqësore, fermeri do ta marrë pa TVSH nga tregtari sipas ligjit që na tha përfaqësuesi i Ministrisë së Financave. Kjo TVSH që i është ngarkuar tregtarit, që ka importuar makinerinë, ku do të shkojë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e drejtë, sepse e ka në kosto tregtari atë TVSH.

Ai e ka paguar. Pra, kemi një pengesë të zinxhirit të TVSH-së teknikisht, kështu që duhet ta çlironi edhe tregtarin si fermerin që të importojë pa TVSH dhe mos kërkon plotësim dokumentesh, por bëni listën e makinerive edhe në zërin “makineri pa TVSH” që të çlirojmë

edhe tregun, edhe tregtarët, edhe fermerët, edhe bujqësinë ta çojmë përpara dhe të mos i krijojmë pengesa artificiale.

Niko Peleshi - Ju, drejtor, a keni ndonjë koment? A e keni të qartë?

Nikolin Lera - Nuk kam ndonjë koment, por do të bashkëpunojmë me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Bujqësisë për ta parë zbatimin, por unë e ritheksoj se zbatimi në sistem nuk ka ndryshuar, një pjesë e makinerive mund të importohen nga të gjithë, një pjesë tjetër nga fermerët, nga agrobiznesi në bazë të kushteve që ka VKM-ja. Megjithatë lind nevoja të jemi më të detajuar që dogana ta ketë më të saktë zbatimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi-Jo, puna është të mos dorëzohemi.

Fatos Pogoni - Zoti Niko, unë jam shumë dakord me ju, por kështu ne nuk kemi se çfarë të bëjmë, do të dorëzohemi. Zoti Lera tha se ka dy interpretime të ndryshme. Kjo nuk qëndron në logjikën time. Vendimi nr. 953 i vitit 2014 e përcakton shumë qartë listën e makinerive bujqësore për fermerët. Mesa kam kuptuar, madje kam pyetur njerëz të ndryshëm të biznesit të mekanikës, por edhe të ligjeve, është shumë e qartë se kjo listë do të implementohet edhe te biznesi, kjo thuhet qartë në vendimin e qeverisë të datës 9 të këtij viti.

Niko Peleshi – Po, zoti Pogoni.

Fatos Pogoni- Unë kam një pyetje për përfaqësuesin e Drejtorisë e Tatimeve: Unë si tregtar si duhet të veprojmë, duhet ta shes me apo pa TVSh?

Unë nuk mund t’i kërkoj NIPT-in fermerit para se t’ia shes.

Nikolin Lera - Nëse ju keni importuar pas 1 janarit, kur ligji ka hyrë në fuqi, makina bujqësore të përjashtuara nga TVSH-ja, ju do ta shisni pa TVSH. Nëse ju për arsye nga më të ndryshmet e keni importuar një pajisje të caktuar me TVSH, ju duhet ta shisni me TVSH, nuk duhet ta mbani si kosto tuajën TVSH-në. Ne do të diskutojmë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në mënyrë që ta adresojmë shumë shpejt këtë punë, vetëm për agregatet.

Niko Peleshi - Furnizimi i makinerive bujqësore është furnizim i përjashtuar. Kjo është në ligj.

Nikolin Lera - Është përdorur termi “makina”, siç ka qenë.

Niko Peleshi – Aty thuhet “bazuar në germën “n”, përcaktuar në anekset 1 dhe 2”.

Nikolin Lera -Detajet teknike mund t'i diskutojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Sot jemi mbledhur këtu për të sqaruar se çfarë duhet të bëhet. Sot jemi me 6 shkurt dhe ka 1 muaj e 6 ditë që ligji ka hyrë në fuqi. Në fakt, duhej të fillonte zbatimi sipas asaj që ju keni propozuar dhe ne kemi miratuar, sepse propozimin në qeveri e ka bërë Ministria e Financave.

Ju thoni që lista ka ardhur *copy paste*, dhe nuk ka si të ndryshohet, sepse qytetari kishte të drejtë të importonte para vitit 2019, pra në vitet 2014-2018, pra fermeri me NIPT, ndërsa tani të gjithë fermerët duhet të shkojnë t'i marrin atje me pakicë dhe ne t'i nxjerrim këta jashtë loje, pra atë që bënte fermeri deri dje me nipt, sot ta bëjnë këta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne veprimin e bëmë për fermerët që të përfitojnë sa më shumë dhe të rritet mirëqenia e tyre. Ky është qëllimi për të cilin ne kemi bërë këtë gjë. Sot ne dalim para një vendimi, i cili nuk është i të qartë në zbatim dhe këta njerëz gjenden para një dileme. Si duhet të veprojmë që tregtari të mos pyes këtu nëse do ta shesë me TVSH apo pa TVSH, që ai tjetri të dijë se cilën makineri do ta blejë me TVSH. Të gjitha duhet të jenë të qartësuara, që të ndihmojmë këta njerëz, familjet e tyre dhe të gjithë procesin tregtar dhe bujqësor në Shqipëri.

Edmond Panariti - Përpos vullnetit të mirë tonin për të bërë ndryshimet dhe modifikimet ose për sqaruar paqartësitë që mund të dalin, unë kam një propozim, duhet parë mirë aneksi për pajisjet, çfarë thuhet në ligj dhe sa është zbatuar.

Në rast se ka shkelje, dikush duhet të mbajë përgjegjësi. Fermerëve ose importuesve, që padrejtësisht iu është ngarkuar TVSH-ja, t'iu rimbursohet menjëherë, përpos hetimeve për shkelje, sepse, në rast se ne nuk respektojmë autoritetin e Kuvendit, edhe organet që janë ligjzbatuese nuk zbatojnë vendimmarrjen e shqiptarëve, atëherë ne jemi një shtet jofunksional.

Prandaj, merreni seriozisht këtë histori, shikojeni mirë se çfarë thotë ligji. Këtu del qartë se ka një tendencë për eliminim, dhe duhet parë më tej kjo histori, pse disa pajisje lejohen, kur në tërësi bëhet fjalë për mekanikë bujqësore, ndërsa agregatet, frezat, plugjet e të tjera ngarkohen padrejtësisht. Këtu ne duhet të ndalemi. Të mos jetë thjesht një çështje debati rreth keqkuptimeve. Këto artikulime dhe teknikalitete nuk na interesojnë. Si ligjvënës ne kemi marrë

një vendim, mekanika bujqësore privohet nga TVSH-ja e importit dhe kjo duhet parë në tërësinë e saj, ndaj të shikohet, se kjo për mua është një gjë shumë e rëndë.

Niko Peleshi - Zoti Beqaj, fjala për ju.

Ilir Beqaj – Dua të kthehem tek ajo që thatë, unë mendoj se të gjithëve ju volit që për këto lloj artikujsh ta keni marrëdhënien vetëm me fermerët, sepse kështu hiqni çdo lloj dyshimi që mund t'i lindë administratës për hapësira shmangiesh, sepse administrata do të mbledhë sa më shumë, se për atë qëllim është krijuar. Për më tepër, nuk pajtohem kur thoni, unë nuk e pyes atë se çfarë NIPT-i ke. Minimalisht besoj se këto gjëra që flasim këtu kanë një vlerë të tillë, që edhe fiskalisht ai nuk lejohet të blejë tek ty me lekë në dorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht pra, duke qenë se janë të tillë, do të lëshosh një faturë, që edhe për interesin tënd duhet ta vësh NIPT-in e blerësit, se nuk është fjala për kupon fiskal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai duhet të ketë NIPT fermeri, po nuk pati, mos ia shit! Po ta përsëris, ky qëllim për këtë është bërë, për të ndihmuar atë fshatar që do të merret me bujqësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, të ketë NIPT fshatari, se vetëm kështu e shmangim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

6 mijë e kanë nxjerrë! Deri më 31 dhjetor, ata që e importonin vetë, e nxirrnin, se këtë po thoni ju, ai po të donte e nxirrte. Ne s'po e kalojmë te ju që ai të mos normalizohet...

(Debate pa mikrofon)

Doni ta zgjidhim?

Kush merret me bujqësi? Merret fermeri me NIPT.

(Debate pa mikrofon)

Për çfarë e do emigranti? Bujrum, e merr NIPT-in pa lekë për 24 orë! Do të jetojë këtu ai, apo në Itali?

Niko Peleshi – Dritan, do të flasësh?

Ta dëgjojmë zotin Bici.

Dritan Bici – Ka qenë shqetësimi i kryetarit të komisionit, por njëkohësisht edhe i deputetëve pse nuk ka filluar implementimi i ligjit, sa u përket agregateve bujqësore. Meraku im

ishte që ndoshta ligji ka ndonjë problem që nuk është implementuar ende. Me sa shoh, ligji është i saktë dhe nuk ia vlen të diskutojmë më, sepse detyra jonë si ligjvënës është të bëjmë një ligj të qartë dhe më pas është detyra e të tjerëve ta zbatojnë atë.

E fundit, ne nuk kemi pse të diskutojmë që do të bëhet kështu apo ashtu, sepse ne nuk rregullojmë dot gjë me fjalë. Nëse qeveria nuk vazhdon ta zbatojë, biznesmenët që janë këtu kanë të drejtë ta hedhin në gjyq dhe ai të vendosë se çfarë do të bëhet më pas. Është bërë një ligj, i cili duhet zbatuar, kur nuk e zbaton, duhet penalizuar.

Niko Peleshi – Kjo që thatë ju, është gjë tjetër. Ne si komision parlamentar kemi mundësinë dhe detyrimin që të organizojmë dëgjesa dhe ndërmjetësime të tilla për të garantuar zbatueshmërinë e ligjit. Pra, të mos shkojmë në ekstrem, se nuk mendoj se është një çështje e tillë. Kjo kërkon vetëm një bashkërendim të punës së ministrive, madje edhe brenda Ministrisë së Financave me Drejtorinë e Doganave, mbase edhe ata kanë të drejtë për të bërë ndonjë plotësim apo saktësim në listë. Përderisa zoti Lera, përfaqësuesi Ministrisë së Financave, thotë që edhe në kuptueshmërinë e kësaj ministrie, paketa fiskale ishte një *copy-paste*, një hapësirë që u krijohet importuesve, rishitëse, njësoj si fermerëve, pa bërë diferencime, besoj se ekziston edhe baza ligjore dhe të gjitha mundësitë teknike për ta zgjidhur këtë ngërç.

Ne do të lëmë një afat dhe një përgjegjësi apo ndjekës nga komisioni ynë, që është zoti Vullnet Sinaj, anëtar zëvendësues i këtij komisioni, për të bashkëpunuar apo ndjekur me institucionet, do të propozoja brenda muajit shkurt, të gjitha plotësimet e nevojshme të kuadrit nënligjor, në mënyrë që ajo që u tha me fjalë, të bëhet edhe në praktikë. Pra, nga të gjitha ato artikuj që përjashtohet fermeri nga TVSH-ja, të përjashtohen edhe rishitësit. Këtë duhet të arrijmë. Kjo gjë duhet të kuptohet mirë edhe nga Dogana, nga Tatimet edhe nga Ministria e Financave në tërësi. Deri në fund të shkurtit, ne si komision kërkojmë një raportim nga institucionet se çfarë është bërë dhe si është zgjidhur. Nga komisioni ynë, në dispozicionin tuaj edhe në ndjekje të këtij procesi, ngarkohet zoti Vullnet Sinaj.

Shumë faleminderit për dëgjuesën!

Vullnet Sinaj – Ne duhet të kërkojmë llogari, zoti kryetar! Duhet të kërkojmë llogari pse nuk është zbatuar. Sot ne jemi të qartë se pse nuk është zbatuar.

Niko Peleshi – Dakord! Kërkuam një raportim brenda shkurtit. Ky është detyrim ligjor. ndërkohë, duke falënderuar përfaqësuesit e grupit të interesit, do t'ju kërkoja përfaqësuesve të

institucioneve që të rrinë edhe pesë minuta, se mbase mund të jenë të vlefshme për të ndërtuar një proces, i cili të përfundojë sa më shpejt.

Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Nikolin Lera – Doja ta diskutonim, sepse mbase duhet të gjejmë një zgjidhje të shpejtë. Çështja është te kuptimi i termave. Pra, unë thashë se, ashtu sikurse ishte e shkruar te neni përkatës: “Makinat e importuara nga fermerët përjashtohen nga TVSH në import”, këtë frazë e morëm dhe e futëm te neni i shitjeve të brendshme. Përjashtohen për të gjithë.

Tani, ku qëndron problemi? Si e zbatonte dogana më parë? Nëse unë isha fermer...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Te fermeri keni pasur dy përjashtime në dy nene të ndryshme. Traktori që lëviz, në një nen, dhe agregatet në një nen tjetër.

Nikolin Lera – Jo, jo, ja ta shpjegoj si ka qenë ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, tashti!

Në nenin 38 thuhet: “Importimi i makinerive dhe pajisjeve është i përjashtuar, në funksion të realizimit të kontratave të investimeve në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit.”.

Pra, ç’do të thotë? Nëse ti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja ta shpjegoj. Lista është e njëjtë edhe për këtë, edhe për importet e tjera. Nuk ka dy lista. Pra, si e zbatonte dogana? Pse është vënë kjo pikë këtu? Sepse kjo përfshin jo vetëm importimin, makinat bujqësore ose agregatet, por edhe çdo makineri, edhe një linjë ulliri, për shembull. Prandaj është përdorur terminologjia “makineri dhe pajisje”, sepse është shumë e gjerë. Ndërkohë, për importin e makinave bujqësore është përdorur termi makina. Një pikë tjetër e të njëjtit nen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë bëmë ne? Këtë pikën tjetër e futëm për të gjithë. Tani, çfarë thotë dogana?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'kishte arsye, sepse as nuk u kërkua dhe as nuk ke çfarë t'i ndryshosh kësaj. Tani, ku e ka problemin dogana? Dogana thotë kështu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Traktori është në një pikë, freza është te pika tjetër.

Nikolin Lera – Jo, freza nuk është te pika tjetër. te pika tjetër është një investim që do të bëjë një fermer, në kuptimin e makinerive dhe pajisjeve. Nuk është thënë askund që freza është në vend tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë këtë pyetje i bëra zotërisë nga dogana: më jep përkufizimin se çfarë quhet makinë bujqësore. Në qoftë se makinë bujqësore quhet vetëm traktori, atëherë freza nuk është, por në qoftë se makinë bujqësore, siç tha ai zotëria... ose ti e ke futur për fermerin pa TVSH, bashkë me agregatin, pra traktor bashkë me agregat, atëherë pse nuk e fut tashti? Se po futemi në telashe të pafundme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – S'kemi dyshime për traktorin. Ai të thotë: fshatarin e përjashtove, pse s' më përjashton edhe mua sot? Fshatarit ia përjashtove frezën?

Thanas Andoni – Jo, nuk është përjashtuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Mos na fut në zbërthim teorik. Flasim konkretisht. Ai e ka pyetjen shumë konkrete: fshatarin e fut? Këtij pse ia heq?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Tregtari sivjet pse nuk përjashtohet nga TVSH-ja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera – Ky ligj u ka vajtur për mendim edhe doganave. S'është se e bëri ministri i Financave vetëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj se ka dy zgjidhje: njëra zgjidhje është që dogana të bindet se makinë është edhe freza. Nuk e di nëse Ministria e Bujqësisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dyta, nëse është e nevojshme, të bëjmë ndonjë saktësim urgjent në VKM, që të miratohet shpejt, të qetësohen këta dhe ta zgjidhim problemin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Unë nuk mora përgjigje: pse fermeri përjashtohet, ndërsa tregtari nuk përjashtohet? S'ma ke dhënë përgjigjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera – Ai zotëria atje tha se i fut në të njëjtin kod.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ai thotë se do të importojë, do të sjellë tridhjetë traktorë, me gjithë setin e pajisjeve, pra frezën, do ta lejosh ti ta importojë apo jo? Si do të bësh?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Pavarësisht nga mjeti, taksimi duhet të jetë njësoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera – Kjo nuk ka sens. Në qoftë se tregtari sjell një set traktorësh bashkë me tërë pajisjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e sjell me një faturë traktorin me frezë. Po ta sjellë me një faturë, përjashtohet. Po ta sjellë me dy fatura, jo.

Ilir Beqaj – Ka edhe diçka tjetër: traktori dhe freza kanë cikle amortizimi të ndryshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera – Duhet një zgjidhje teknike. Unë nuk jam eksperti i kodeve. Zgjidhet në situatën e tanishme, ose duhet urgjent një ndërhyrje në VKM.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të thoni gjithmonë: ne vetëm zbatues jemi, se pastaj pengesa te ju vjen. Na thoni çfarë ndryshimesh duhet të bëjmë.

Niko Peleshi – Më falni, më falni, se unë duhet të shkoj te Konferenca e Kryetarëve, ndaj më duhet të largohem. Mbase drejtori ka nevojë të thellohet pak, kështu që të mos insistojmë më tepër. Një gjë është shumë e qartë dhe kot sa e komplikojmë. Ndryshimi që ne kemi bërë në paketën fiskale nuk ka pasur fare lidhje me kategoritë, me artikujt, me përshkrimet, me listën. S'ka pasur lidhje fare me të. Është siç e tha Nikoja. Ka pasur të bëjë vetëm me

kategori përfituese, jo me kategorikë e artikujve të doganës. Pra, nuk jemi marrë fare nëse është mekanikë apo makineri. Jemi marrë vetëm me faktin nëse janë fermerë apo rishitës. Janë futur edhe rishitësit në lojë. Pra, çfarë përfitonte fermeri duhet ta përfitojë edhe rishitësi, në kuptimin e ligjit. S'ka interpretim tjetër. Lista s'ka ndryshuar. Nuk mund të hyjmë në listë dhe të bëjmë diferencime. Lista është ajo që ishte. Është shtuar vetëm kategoria e përfituesve. Kësisoj, ju lutem që, edhe me Ministrinë e Bujqësisë, edhe me Ministrinë e Financave, mblidhuni së bashku, nën mbikëqyrjen e zotit Sinaj, i cili e ka merak vetë. Në qoftë se ju duhet ndonjë plotësim, ndonjë saktësim, që të jeni edhe ju të qetë në zbatueshmëri, e kam fjalën për doganat, bëjeni. Në qoftë se është thjesht një interpretim i ligjit ashtu siç duhet, atëherë bini dakord që duhet interpretuar qartësisht, njëllor nga të gjitha institucionet, që mundësisht të fillojë puna që nesër. dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deri të hënën do të marrim një informacion nga Vullneti, për të parë se ku jemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera – Ne do të mblidhemi me Ministrinë e Bujqësisë dhe me doganën, që të shikojmë opsionin më të shpejtë.

Niko Peleshi – Duhet të merremi edhe me tatimet, sepse edhe nga ata ka shqetësime.

Nikolin Lera – Shqetësimi i tyre është që administrata jonë nuk e lexon akoma ligjin dhe i thotë: ku ta di unë! Ajo është çështje e ofrimit të shërbimit. Çështja është si do ta zgjidhim në import.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord! Kur të duash! Nuk e kundërshtoj.

MBYLLET MBLEDHJA